

VENDIM
Nr. 53, datë 26.1.2012

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE
MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR ZYRËN VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, LEZHË, TË MJEDISEVE TË KATIT PËRDHES DHE TË TRUALLIT
FUNKSIONAL, PJESË TË PRONËS NR. 981, ME EMËRTIM “SHTËPIA E USHTARAKËVE”,
LEZHË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË
MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Drejtësisë, për zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në Lezhë, të mjediseve të katit përdhes, me sipërfaqen ndërtimore 740 (shtatëqind e dyzet) m² dhe të truallit funksional, me sipërfaqe 802 (tetëqind e dy) m², gjithsej 1 542 (një mijë e pesëqind e dyzet e dy) m², pjesë të pronës nr.981, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, Lezhë, sipas planvendosjes dhe planimetrisë, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për t’i përdorur për vendosjen dhe ushtrimin e aktivitetit të Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë.

2. Mjediset e katit përdhes, me sipërfaqe ndërtimore 740 (shtatëqind e dyzet) m² dhe truall funksional me sipërfaqe 802 m² (tetëqind e dy) m², gjithsej 1542 (një mijë e pesëqind e dyzet e dy) m², pjesë të pronës nr. 981, me emërtim “Shtëpia e Ushtarakëve”, Lezhë, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

3. Ministria e Drejtësisë dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Lezhë, të mos pengojnë, si dhe të krijojnë kushtet për funksionimin normal të rrugës së kalimit dhe të hyrjes në mjediset e tjera të godinës së pronës nr.981 “Shtëpia e Ushtarakëve”, Lezhë.

4. Ndalohet tjetërsimi, dhënia në përdorim apo ndryshimi i destinacionit të mjediseve të pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Drejtësisë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha